



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

Nr. 41/1 Prot
Dt. 31.07.2017

VENDIM

Nr. 35 Datë 31.07 2017

“Për miratimin e kërkesës për leje për rehabilitim e shtratit të lumit Shkumbin, në zonën e Xibrakës , Bashkia Elbasan, subjektit “Bajrami - N” shpk”.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me Nr. 309, datë 31.05.2016, për “Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Identifikimin e Nevojave për Rehabilitimin e Shtretërve të Lumenjve”, bazuar në shkresën Nr.9706 Prot, date 16.12.2016 të Ministrit të Bujqësisë ku dërgohet lista e segmenteve të miratuara për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës për leje për rehabilitim e shtratit të lumit Shkumbin, në zonën e Xibrakës , Bashkia Elbasan, subjektit “Bajrami - N” shpk”.

Specifikimet e burimit ujor:

Koordinatat :

X 45 58 772 Y 44 30 943

X 45 58 942 Y 44 33 799

Sip. e rehabilitimit	0.6 Km ²
Sasia e materialit për të gjithë periudhën e kërkuar	446 700 m ³
Investimi i planifikuar për mbjelljen e pemëve në nr. pemësh	1000 pemë plep,shelg,
Germim zhavorri me skrepër, transport me vëllim 446 700 m ³ dhe ndërtim argjinaturash me lartësi 2.0 m përgjatë shtratit të lumit.	

Prurjet sipas studimit.

Prurja mesatare vjetore	Q _{mes.}	60m ³ /sek
Prurja mesatare e muajit më të thatë	Q _{min.}	25 m ³ /sek
Periudha e rehabilitimit të shtratin të lumit 5 vjet.		

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

**PËRGJEGJËS ABU
SHKUMBIN**



**KRYETARI I KBU SHKUMBIN
PREFEKTI I QARKUT
ELBASAN**

